



KOMUNA E MALISHEVËS



# BULETINI

Nr. 156 – Nëntor – 2016 – Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje gjatë aktiviteteve të Nëntorit



## Përmbajtja:

Morina: Bellanicës po i ndryshohet pamja për të mirë .....	3
Tërpeza e Poshtme, bëhet me rrjet të ri të energjisë elektrike .....	3
Rritet niveli i ujit në lumin Mirusha .....	4
Shkaktohen përmbytje në Malishevë, mbyllen shkollat.....	5
Vazhdon gjendja e rënduar nga përmbytjet në Malishevë .....	5
Qetësohet situata nga vërshimet në Malishevë, por janë shkaktuar dëme .....	6
Përmbytjet shkaktuan dëme të konsiderueshme .....	7
Komuna ndihmon familjet e evokuara gjatë vërshimeve.....	8
Filloi vendosja e kabinave të pritjes nëpër stacione të autobusëve .....	8
RKSHK i ndanë mirënjohje kryetarit Begaj, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare .	9
UNDP përkrahë ekipet emergjente me pajisje konkretizuese .....	10
Kryetari: Bujqit do ti bëjnë prioritetet e investimeve.....	10
Hapet panairi artizanale dhe i produkteve vendore.....	11
Me shumë aktivitete u shënuan 28 Nëntori në Malishevë .....	11
U miratua rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjopa komunale për vitin 2017.....	13



## Morina: Bellanicës po i ndryshohet pamja për të mirë

### Malishevë, 1 nëntor



Fshati Bellanicë i Malishevës, është njëri prej fshatrave më karakteristik, pasi është prej atyre vendbanimeve të rralla në vend, që vet banorët e ruajnë hapësirën publike, si dhe është një prej fshatrave që shumë rrugë e trotuare dhe projekte të ngjashme në të mirë të banorëve, i kanë realizuar vet, ose me bashkëfinancim, por investimet komunale, kanë qenë më të pakta. Për këtë qëllim, edhe Komuna e Malishevës, është duke i bërë disa investime këtë vit, përmes së cilave, këtij

fshati po i ndryshohet pamja për të mirë.

Drejtorja e Urbanizmit, përkatësisht drejtori Ahmet Morina, ka bërë të ditur se në këtë fshat, janë duke u realizuar disa projekte, që do të ndikojnë në mirëqenien e banorëve, pasi lidhen direkt me jetesën dhe veprimtarinë e banorëve të Bellanicës. “Kemi investuar kohë më parë në kanalizimin e fshatit, ndërsa tani janë u ndërtuar edhe një kilometër kanalizim për lagjen e Sertollëve. Ky projekt po realizohet krahas projekteve tjera në Bellanicë”, ka thënë Morina.

“Kemi filluar dhe presim që deri në fund të javës, rruga kryesore e fshatit, të ndriçohet, ndërsa janë duke u shtruar edhe disa rrugë brenda lagjeve. Po ashtu, kemi filluar edhe projektin e ndërtimit të fushës së sportit në ambientet e shkollës së fshatit, fushë e cila përveç nxënësve, do të shërbej edhe për të rinjtë e fshatit, kurse fusha do të jetë sipas standardeve” ka deklaruar drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, drejtori e cila i udhëheq dhe mbikëqyr realizimin e projekteve.

“Banorët e Bellanicës, i meritojnë këto investime, sikur çdo vendbanim tjetër në Malishevë, por ruajtja e hapësirës publike nga vet banorët, ruajtja e hapësirave të gjelbra, vetiniciativa për shumë projekte në fshat, na ka bërë neve, që të investojmë në projekte, të cilat e bëjnë Bellanicën, një vendbanim tërësisht të urbanizuar, duke e marrë pamjen e një qyteti të vogël”, tha Morina.

## Tërpeza e Poshtme, bëhet me rrjet të ri të energjisë elektrike

### Malishevë, 3 tetor

Fshati Tërpezë e Poshtme, falë një investimi të KEDS-it dhe i përkrahur edhe nga Komuna e Malishevës, është bërë me trafo stacion dhe rrjet energjetik të ri. Këtë investim e ka konfirmuar menaxheri i njesisë së KEDS-it në Malishevë, Dardan Krasniqi, si dhe banorët e fshatit, të cilët përmes rrjeteve sociale, i kanë falënderuar për këtë investim. Gjendja e rrjetit energjetik në këtë



fshat, ka qenë jo e mirë dhe rrjedhimisht ka pasur edhe probleme me furnizim të mirë me energji elektrike.



Sipas menaxherit të njësisë së KEDS-it në Malishevë, Dardan Krasniqi, rrjeti energjetik në Tërpezë të Poshtme, është rregulluar, si dhe është vendosur një trafo stacion i ri, dhe me këtë investim është rregulluar rrjeti energjetik në tërësi, në këtë pjesë të fshatit.

Nga ana tjetër, vet banorët e fshatit, përmes rrjeteve sociale, e kanë falënderuar kompaninë e shpërndarjes dhe mirëmbajtjes së rrjetit energjetik, KEDS, njësi në Malishevë. Banorët në veçanti e kanë falënderuar menaxherin Krasniqi, për angazhimin e tij dhe të gjithë punëtorët për rregullimin e rrjetit energjetik në fshat.

## Rritet niveli i ujit në lumin Mirusha

### Malishevë, 8 nëntor



Si rezultat e reshjeve të shumta gjatë ditëve të fundit niveli i ujit në lumin Mirusha, është rritur dukshëm, por deri në këtë moment nuk janë shkaktuar përmytje dhe as depërtime të ujit në shtëpi banimi. Në disa vende lumi ka dalë nga shtrati, por pa shkaktuar ndonjë rrezik për qytetarët. Nëse vazhdojnë reshjet e shiut, pritet që fillimisht të bllokohet rruga Mirushë-Gurbardh, pjesa e urës mbi liqenin Mirusha, ku niveli i ujit është në nivel me rrugën, përkatësisht urën mbi liqe.

Lumi Mirusha, ka dalë nga shtrati në hyrje të fshatit Banjë, por nuk janë shënuar dëme, ndërsa niveli i ujit është i rritur përgjatë tërë shtratit të lumit.

Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim, gjatë tërë ditës ka qenë në gatishmëri dhe në inspektim të vazhdueshëm të situatës. Sipas kësaj drejtorie, nëse vazhdojnë reshjet e shiut, rrezik mbetet diga e liqenit në Mirushë, si dhe vendbanimet përgjatë lumit Mirusha, ku mund të ketë përmytje eventuale.

Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim, do të vazhdojë të vëzhgojë situatën pa ndërprerë. Në vëzhgim të situatës janë edhe Policia e Kosovës, duke i vëzhguar pikat që konsiderohen më problematike.



Një nga faktorët e daljes nga shtrati të lumit, janë edhe mbeturinat që persona të pandërgjegjshëm i gjuajnë në lum ose përgjatë lumit.

## Shkaktohen përmbytje në Malishevë, mbyllen shkollat

### Malishevë, 9 nëntor



Si pasojë e shirave të rrëmbyeshëm dhe të pandërprera, lumi Mirusha ka dalë nga shtrati duke shkaktuar përmbytje në disa pjesë të Malishevës. Po ashtu edhe në vendbanimet tjera ka sasi të mëdha të ujit, pothuajse në të gjitha vendbanimet. Si rezultat i kësaj, të gjitha shkollat në Malishevë, sot janë mbyllur, ndërsa kjo ditë e humbur, do të zëvendësohet një ditë tjetër.

Rrugët Malishevë-Kijevë, Mirushë-Gurbardh, si dhe qendra e qytetit në Malishevë, janë të pakalueshme, ndërsa gjendja e rëndë është në aksin rrugor Malishevë-Autostradë-Duhël.

Gjendja e rënduar është edhe në liqenin Mirusha, pasi uji ka mbuluar edhe digën, ndërsa në disa vende, përkatësisht përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha, është e rënduar. Në disa shkolla uji pothuajse ka hyrë në objekte.

Luten qytetarët të mos lëvizin pa nevojë, pasi gjendja në rrugë është e rënduar.

Të gjitha ekipet emergjente, janë në terren duke i ndihmuar qytetarët që kanë nevojë, si drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, njësia e zjarrfikësve dhe shpëtimit dhe Policia e Kosovës.

## Vazhdon gjendja e rënduar nga përmbytjet në Malishevë

### Malishevë, 9 nëntor

Dalja nga shtrati e lumit Mirusha, si dhe rrjedhave tjera të ujërave, ka bërë që situata të rëndohet nga përmbytjet. Disa rrugë që qojnë në fshatra janë bllokuar. Aktualisht mbeten të bllokuara rrugët që të qojnë në Turjakë, Panorc, Rud, Llapçevë dhe Bubël, pastaj rruga Malishevë-Duhël, Malishevë-Kijevë, Mirushë-Gurbardh, ndërsa pjesërisht është bllokuar fshati Lubizhdë.



Situata e rëndë vazhdon në Bellanicë, Banjë, Malishevë dhe vendbanimet tjera që shtrihen përgjatë lumit Mirusha, ndërsa prurjet e ujit duken shumë më të mëdha se të vërshimeve të janarit të këtij viti.

Po ashtu edhe liqeni në Mirushë, është i stërbushur me ujë, më shumë se asnjëherë më parë.

Sot, deri në mesditë, janë evakuuar disa familje, si në Marali, Mirushë dhe në Malishevë.

Sipas drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, të gjitha njësitë emergjente janë në terren dhe deri më tani nuk ka të lënduar si pasojë e përmbytjeve.

## Qetësohet situata nga vërshimet në Malishevë, por janë shkaktuar dëme

### **Malishevë, 10 nëntor**

Situata nga vërshimet e dy ditëve të fundit, është qetësuar pas ndërprerjes së shirave, por gjatë këtyre vërshimeve, janë shkaktuar disa dëme, kryesisht në bujqësi, por edhe në infrastrukturë në përgjithësi. Si pasojë e vërshimeve, është bllokuar një lagje në fshatin Guncat, pasi është shembur një pjesë e rrugës që lidhë lagjen me fshatin dhe rrugët tjera.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Sejdi Paçarizi, në këtë lagje, për shkak të rrëshqitjeve të tokës, është shembur edhe rruga, duke ju pamundësuar lëvizjen me vetura banorëve të kësaj lagjeje. Rruga është dëmtuar edhe në aksin rrugor Malishevë-Duhël, përkatësisht në fshatin Banjë, si dhe është dëmtuar një rrugë në fshatin Lubizhdë.

Edhe diga në Mirushë, është dëmtuar edhe më shumë, por ende nuk ka rrezik, pasi sasia e ujit është ulur për dy metra në liqenin e Mirushës.

Si pasojë e reshjeve, shumë puse janë ndotur dhe uji është i papërdorshëm.

Përndryshe, të gjitha rrugët janë të hapura dhe përjashtuar një lagje në Guncat, qarkullimi i qytetarëve zhvillohet pa problem.

Komuna e Malishevës, ka formuar komisionet për vlerësimin e dëmeve, ndërsa Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, vazhdon të mbetet në gatishmëri të plotë.



## Përmbytjet shkaktuan dëme të konsiderueshme

### Malishevë, 14 nëntor



Përmbytjet e javës së kaluar janë përcjellë me dëme të konsiderueshme në bujqësi dhe në infrastrukturë, ndërsa problematike mbetet gjendja e digës dhe urës në liqenin në Mirushë. Kështu në mbledhjen e rregullt të së hënës, të Këshillit të Drejtorëve, të drejtuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Përmbytjet ishin dhe tema kryesore e diskutimit në këtë mbledhje.

Në këtë mbledhje, për situatën e përgjithshme gjatë dhe pas përmbytjeve, ka raportuar zyrtari për emergjenca në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Halit Mazreku, sipas të cilit, sasia e ujit ka qenë shumë e madhe, si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut, dhe ka dëme të konsiderueshme në bujqësi e në infrastrukturë. Është dëmtuar një rrugë në Guncat, në të cilën është dashur të intervenohet me urgjencë, pastaj rruga në Banjë, ndërsa në gjendje të rëndë mbeten diga dhe ura në liqenin në Mirushë. Sipas Mazrekut, janë evakuuar dhjetë familje, ku një prej tyre tashmë është zhvendosur në një fshat tjetër.

Për vlerësimin e dëmeve nga përmbytjet, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka formuar edhe komisionin për vlerësimin e dëmeve të shkaktuar.

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, drejtorët e drejtorive, kanë raportuar për punët dhe angazhimet e tyre gjatë javës së kaluar dhe angazhimet që i kanë planifikuar për javën në vijim. Sipas drejtorëve të drejtorive, është duke vazhduar realizimi i projekteve kapitale, sipas planifikimeve dhe pavarësisht kushteve atmosferike, projektet janë drejtë përfundimit.

Po ashtu në mbledhjen e sotme, u raportua edhe për përgatitjet për shënimin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit Kombëtar Shqiptar.

Pas mbledhjes, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, bashkë me drejtorin për Mbrojtje dhe Shpëtim, Sejdi Paçarizi dhe drejtorin për Shërbime Publike, Milazim Morina, kanë vizituar digën në liqenin në Mirushë, për të parë nga afër gjendjen e digës, pas rënies së nivelit të ujit.



## Komuna ndihmon familjet e evokuara gjatë vërshimeve

### Malishevë, 13 nëntor



Komuna e Malishevës, përkatësisht Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, dje dhe sot ka vazhduar me përkrahjen e dhjetë familjeve të evokuara gjatë ditëve të vërshimeve të kësaj jave. Këto familje janë mbështetur me pako familjare, me qëllim të tejkalimit të situatës emergjente, që janë ballafaquar këto ditë.

Sipas zyrtarit për emergjenca, në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Halit Mazreku, gjatë vërshimeve, janë detyruar ti largojnë dhjetë familje

nga shtëpitë e banimit të tyre, ndërsa këto familje janë mbështetur me ndihma emergjente, me qëllim të tejkalimit dhe përballimit të kësaj situatë, pasi të njëjtëve, ju kanë dëmtuar të mirat materiale, përkatësisht ushqimet dhe veshmbathjet.

Këto familje janë ndihmuar me pako ushqimore, higjienike dhe veshmbathje, përkatësisht me miell, vaj, sheqer, patate, oriz, dhe ushqime tjera, si dhe me pako higjienike, si dhe me batanije për tu mbuluar.

## Filloi vendosja e kabinave të pritjes nëpër stacione të autobusëve

### Malishevë, 17 nëntor



Në Komunën e Malishevës, ka filluar implementimi i projektit për vendosjen e kabinave të pritjes, nëpër stacione të autobusëve, në të gjitha rrugët kryesore. Qëllimi i këtij projekti, është vendosja e këtyre kabinave, ku qytetarët që presin, të jenë të mbrojtur nga reshjet atmosferike dhe të mos presin në këmbë, por të ulur.

“Realizimi i projektit ka filluar dhe brenda një jave, presim që ky projekt të realizohet në tërësi, ku këto busshalltera, apo kabina të pritjes, do të vendosen në të gjitha rrugët kryesore, ose më saktë në vend stacionet, ku ka frekuentim më të madh të qytetarëve, të cilët janë të detyruar të presin autobusin”, tha Ahmet Morina, drejtor i urbanizimit, drejtori e cila e realizon këtë projekt shumë domethënës.



Vendosja e busshallterëve, apo kabinave të pritjes nëpër stacione të autobusëve, është projekt që realizohet nga buxheti i Komunës së Malishevës dhe shuma e projektit është 29 mijë euro.

Kabinat, do të vendosen në të gjitha stacionet e autobusëve, ku ka numër më të madh të atyre që presin, si në rrugët magjistrale, ashtu edhe në rrugët brenda vendbanimeve, e në veçanti vendbanimeve të mëdha, ku numri i nxënësve dhe studentëve, që udhëtojnë me autobus, është shumë i madh.

## **RKSHK i ndanë mirënjohje kryetarit Begaj, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare**

### **Malishevë, 18 nëntor**



Në prag të shënimit të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, organizata Rezistenca Kombëtare e Shqiptarëve të Kosovës (RKSHK) “Enver Hadri”, me seli në Bruksel, ka ndarë mirënjohje për Kryetarin e Komunës së Malishevës, për kontributin e dhënë në çështjen Kombëtare. Mirënjohjen zyrtarisht, sot ja kanë dhënë kryetari i kësaj organizate z.Riza Kadriaj-Budakova dhe anëtari i rezistencës, që punon në territorin e Kosovës, z.Musli Kabashi.

Kryetari Begaj i ka falënderuar për këtë nderim që i bëhet, ndërsa i ka dhënë mbështetje RKSHK “Enver Hadri”, me seli në Bruksel, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare.

Në arsyetimin e dhënë, bashkë me mirënjohjen thuhet: Këshilli i Rezistencës Kombëtare Shqiptare, me seli në Bruksel, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë: 20 shtator 2016, pos vlerësimit të zhvillimeve aktuale politike, vendosi si në vijim:

1. Të ndaj Mirënjohje për Personat Kontributdhënës, Subjektet, Institucionet, Familje, të cilat kontribuuan nga viti 1968 e deri në Pavarësimin e Republikës së Kosovës.
2. Nga anëtari i Rezistencës, z.Musli Kabashi, t’a pranojë anëtar të Këshillit të Rezistencës me seli në Bruksel, i cili edhe më tej do të punoj në territorin e Kosovës dhe për punën e aktivitetin e tij me anëtar tjerë do t’a njoftojë Këshillin në Bruksel.
3. Këshilli i RKSHK është aktiv edhe në përcjelljen e kontributdhënësve për zhvillimin ekonomikocial, për punësimin, për imazhin pozitiv dhe për integrimin e Republikës së Kosovës në strukturat euroatlantike dhe organizatat tjera ndërkombëtare.



## UNDP përkrahë ekipet emergjente me pajisje konkretizuese

### Malishevë, 18 nëntor



United Nation Development Programme (UNDP), sot ka përkrahur ekipet e njësisë së zjarrfikësve dhe shpëtimit në Malishevë, me mjete konkretizuese, përkatësisht me pajisje për intervenime në raste të përmbytjeve, siç janë rroba, çizme të gjata, të shkurta, jelek uji, gjenerator dhe mjete tjera, me të cilat ekipet emergjente mund të kryejnë intervenimet e tyre, kur ka raste të përmbytjeve.

Këto mjete, sot i ka sjellë ekipi i UNDP, i udhëhequr nga zyrtari i lartë i UNDP-së në Kosovë, z.Fumihiko Tominaga, i cili këto mjete ja ka dorëzuar drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Sejdi Paçarizi.

Drejtori Paçarizi, e ka falënderuar UNDP dhe z.Tominaga, për këtë ndihmë konkrete për ekipet e ndërhyrjes, pasi këto mjete kanë qenë shumë të nevojshme për kryerjen e ndërhyrjeve në raste të përmbytjeve dhe vërshimeve, probleme të cilat gjatë këtij viti është përballur Komuna e Malishevës.

UNDP, këto mjete i ka sjellë, pas kërkesës së drejtorisë përkatëse për mjetet për të cilat kanë nevojë ekipet emergjente, gjatë menaxhimit të situatave të tilla dhe UNDP e ka përkrahur Komunën e Malishevës, me këto pajisje.

## Kryetari: Bujqit do ti bëjnë prioritetet e investimeve

### Malishevë, 21 nëntor

Sot është mbajtur mbledhja e rregullt e së hënës, e Këshillit të Drejtorëve, ku është prezantuar edhe drejtori i ri i Drejtorisë për Bujqësi, Murat Hoxha. Në këtë mbledhje kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, gjatë diskutimeve, ka thënë se do të organizohet një takim me bujqit, në mënyrë që orientimi i investimeve të komunës në fushën e bujqësisë, do të përcaktohet nga vet bujqit, pasi ata i dinë më së miri nevojat e investimeve.



“Ne kemi investuar në vazhdimësi në bujqësi, por nga viti i ardhshëm orientimin e prioriteteve do ta bëjnë vet bujqit”, tha kryetari Begaj, i cili kërkoi nga drejtori i bujqësisë, Murat Hoxha, që të organizohet një takim me bujqit e Komunës së Malishevës, për këtë çështje.

Përndryshe në mbledhjen e sotme të rregullt të Këshillit të Drejtorëve, u raportua për aktivitetet e drejtorive komunale gjatë javës së kaluar dhe për planifikimet për javën në vazhdim, si dhe për angazhimet në përmbylljen e projekteve kapitale, ku shumica janë në përfundim e sipër dhe shpresohet që gjatë javës të përfundojnë.

Po ashtu në mbledhjen e sotme, u bë e ditur, se është hapur kanali shkarkues i digës në liqenin në Mirushë, që gjatë sezonit dimëror, do ta shkarkoj ujën nga liqeni, ndërsa në Gjimnazin “Hamdi Berisha”, është rregulluar ngrohja, pasi ka pasur defekte në fillim të këtij sezoni të ngrohjes.

## Hapet panairi artizanal dhe i produkteve vendore

### Malishevë, 24 nëntor



Në kuadër aktiviteteve me rastin e shënimit të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, sot në Malishevë, është hapur panairi artizanal dhe i produkteve vendore. Panairët e këtilla, tashmë janë tradicional dhe organizohen, së paku dy herë brenda vitit. Risi e këtij panairi, është pjesëmarrja e shitësve të librave, që ka zgjuar interesim të jashtëzakonshëm.

Panairin e kanë vizituar edhe nënkryetari i Malishevës, Rexhep Mazreku, bashkë me përgjegjësit e drejtorive komunale, të cilët i kanë uruar pjesëmarrësit dhe i kanë inkurajuar për vazhdimin e kultivimit të traditës shqiptare, si dhe për kultivimin e ushqimeve tradicionale.

Nga ana tjetër, vet pjesëmarrësit, e kanë përshëndetur komunën për këtë organizim të panairit, ku gjithmonë, ruajtësit dhe kultivuesit e traditës, trashëgimisë dhe kulturës shqiptare, po kanë mundësi që ta paraqesin edhe para publikut, artin e tyre dhe ushqimet tradicionale.

Ndërsa, risia e këtij viti, një minipanair i librit, i cili gjithashtu kishte zgjuar interesim të jashtëzakonshëm të lexuesve, ku nuk ka munguar edhe shitja e librave, madje në masë të madhe.

## Me shumë aktivitete u shënuar 28 Nëntori në Malishevë



## **Malishevë, 28 nëntor**



Sot, Dita e Flamurit Kombëtar, është shënuar me aktivitete të ndryshme në Komunën e Malishevës. Fillimisht, Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka mbajtur një mbledhje solemne, ndërsa më pas janë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë, si dhe nderime para shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari në Malishevë. Po ashtu, homazhe dhe nderime janë bërë edhe në Prekaz, ndërsa në Llapçevë, është

zbuluar pllaka me emrat e të vrarëve gjatë luftës së fundit.

Në mbledhjen solemne, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, tha se “nëntori është muaji i ngjarjeve të rëndësishme për kombin shqiptar, ndërsa vet data 28 Nëntor, është e shenjtë, pasi në këtë datë, u ngrit flamuri kombëtar në Krujë, nga Skënderbeu, pastaj në Vlorë nga Ismail Qemali dhe në këtë datë lindi hero i ynë Adem Jashari”. Kryetari Begaj, gjatë fjalimit të tij, përmendi sakrificat e popullit shqiptar, ndër shekuj.

Edhe kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaçi, në seancën solemne, për nder të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, foli për rëndësinë e kësaj date dhe për përpjekjet dhe sakrificat e popullit shqiptar në të gjitha trojet, dhe për luftërat e lavdishme shqiptare për pavarësi dhe liri.

Pas nderimeve dhe homazheve në Malishevë, Kleçkë e Prekaz, në fshatin Llapçevë, është bërë inaugurimi i lapidarit dhe zbulimi i pllakës përkujtimore për 16 viktimat e fshat, gjatë luftës së fundit në Kosovë. “Kjo është një shenjë e sakrificës dhe e përpjekjeve tona për lirinë e fituar me gjakun e atyre që sakrifkuan për vendin. Këta janë emra të paharrueshëm të cilët përgjithmonë do të kujtohen”, tha mes tjerash kryetari Begaj, në ceremoninë e zbulimit të pllakës me emrat e të vrarëve .

16 banorët e fshatit Llapçevë, janë vrarë kryesisht në vitin 1999 nga forcat paramilitare serbe, në Llapçevë dhe në Krelan, ku prej tyre pesë persona ende janë të pagjetur.

Shënimeve të festës kombëtare të 28 Nëntorit, i kanë parapri edhe shumë aktivitete tjera kulturore dhe sportive, ndërsa sot do të luhet edhe finalja në futboll të vogël, si dhe është hapur edhe një ekspozitë artistike në Qendrën e Rinisë në Malishevë.



## U miratua rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2017

### Malishevë, 30 nëntor



Kuvendi i Komunës së Malishevës, drejtuar nga kryesuesi Aziz Thaçi, ka mbajtur mbledhjen e dymbëdhjetë të rregullt për këtë vit, ku në mes tjerash, ka miratuar rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2017. Kuvendi i Komunës së Malishevës, gjithashtu ka shqyrtuar dhe miratuar edhe çështje tjera.

Rregulloren e re për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, para anëtarëve të kuvendit e ka paraqitur drejtori për buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, ndërsa kuvendi, me shumicë të votave, e ka miratuara rregulloren për vitin 2017.

Po ashtu kuvendi në mbledhjen e sotme, ka formuar edhe një komisionin të kuvendit, për hartimin e rregullores së punës të Kuvendit të Komunës, për vitin 2017.

Pikë tjetër me rëndësi në mbledhjen e sotme, ishte edhe informimi për punën e Drejtorisë së Urbanizimit, për vitin 2016, informim të cilin e bëri drejtori i drejtorisë, Ahmet Morina. Përveç informimit për punën e kryera gjatë këtij viti, drejtori Morina, është përgjegjës edhe në pyetjet e anëtarëve të kuvendit, për projekte të caktuara.

Pas kësaj, Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e sotme, pas shqyrtimit, ka bërë plotësimin e komitetit për Politikë dhe Financa, me anëtarë të rinj.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e dymbëdhjetë të radhës, ka formuar edhe një komision për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve, lidhur me emërtimin e rrugëve.